

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga e pandehura Shpresa Hyseni, nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.42402/2011, të dt. 23.12.2011 e në bazë të neneve 31 al.3, 39 dhe 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 26.01.2012, nxjerr:

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i Gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.42402/2011, i dt 23.12.2011, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje e këtij aktvendimi u dorëzohet palëve.

DPK	DMP	03-498/2012
01		03.02.2012

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.42402/2011, të dt.23.12.2011 të pandehurën Shpresa Hyseni, nga Prishtina e ka shpallë përgjegjëse:sepse si Gjyqtare në Gjykatën Komunale në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e plotë të pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë i njoftuar se është përfshirë në listën e Zyrtarëve të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë e plotë që e posedojnë. Gjatë kontrollit nga Agjencioni Antikorrupsion i janë gjetur dy paluejtëshmëri në emër bashkëshortit të saj në sipërfaqe prej 4321 m2 dhe 10852 m2 të cilat paluejtëshmëri janë të evidentuara në Zyrën Kadastrale në Pejë me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 3 neni 5 par. 1 dhe 1.1 nenit 15 para. 4 lidhur me nenin 17 para. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë, për të cilën Kundërvajtje, ia shqiptoi gjobën në shumë prej 1.000€. Me të njëjtin aktvendim e pandehura është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5€.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur e pandehura Shpresa Hyseni, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike,shkeljes së ligjit për kundërvajtje dhe vendimit mbi dënimin, më tutje në arsyetim ndër të tjera thekson: se deklarimin e pasurisë në mënyrë të rregullt dhe në afat të caktuar e ka bërë, i ka paraqitur se i ka dy banesa dhe një automjet "Gjip", se asgjë nuk ka fshehur me qëllim nuk i ka ikur paraqitjes së pasurisë të dy ngastrave kadastrale të cilat janë në emër të burrit të saj, por të njëjtat kanë vlerë shumë të vogël dhe në këto dy ngastra bashkëshorti i saj është bashkëpronarë me 1/6 pjesë ideale, por që kjo pasuri ende nuk është shqyrtuar në bazë të trashëgimisë dhe është si pasuri e përbashkët,se këtë lëshim e ka bërë nga neglizhencamuskujdesi dhe se nuk i është kujtuar se kjo pronë evidencohet në emër të bashkëshortit të saj e cila gjendet në Komunën e Pejës, se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është nxjerrë pa u vërtetuar gjendja faktike në mënyrë të plotë dhe për këtë konsideron se është i kundërligjshëm dhe se është nxjerrë duke u bazuar në deklaratë të një zyrtari kadastral ku nuk është vërtetuar mënyra e prejardhjes e kësaj prone dhe se i është fal besimi punëtorit të Agjencionit Antikorrupsion, andaj nga të lartcekurat propozon që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose i njëjti të ndryshohet në kualifikimin juridik dhe dënimin e shqiptuar, ti shqiptohet vërejtje gjyqësore.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi thëniet e ankesës së paraqitur, aktvendimin e goditur, deklaratën e të pandehurës dëshmitarit si dhe shkresat tjera të lëndës dhe konstatoi se ankesa e paraqitur është e bazuar dhe duke e shqyrtuar lëndën edhe sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 219 të Ligjit për Kundërvajtje, aktvendimin e goditur e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë me rastin e zhvillimit të procedurës kundërvajtjeje bazuar në Ligj dhe faktet e kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtjeje ndaj të pandehurës nga Agjencia Kundër Korrupsionit bazohet në Ligjin 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar i cili është nxjerrë më 31. Gusht 2011 dhe ka hyrë në fuqi 30.09.2011, ndërsa e pandehura në bazë të dispozitave të këtij ligji ngarkohet dhe dënohet se nuk ka bërë deklarin e rregullt të pasurisë për anëtarët e familjes (edhe pse nuk ceket as në kërkesë as në dispozitiv të aktvendimit të Gjykatës së shkallës së parë për cilën kohë por sigurisht është aluduar gjerë më 31. Mars 2011) e që ky fakt është dashur të ekzistojë edhe në kërkesë edhe në aktvendim të shkallës së parë, pra kundërvajtja e cila i ngarkohet të pandehurës kualifikohet në Ligj jo ekzistues në kohën e kryerjes së kundërvajtjes dhe se i njëjti është nxjerrë më vonë ashtu siç u cek më lartë dhe se nuk është më i favorshëm për të pandehurën.

Gjykata e shkallës së parë, të pandehurën e shpallë përgjegjëse sepse si Gjyqtare në Gjykatën Komunale në Prishtinë, nuk ka bërë deklarin e plotë të pasurisë duke mos deklaruar dy paluejtshmëri në emër të bashkëshortit së saj, Kolegji vlerëson se Ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën kur i ngarkohet vepra të pandehurës nr. 03/L-151 dhe edhe Ligji tjetër 04/L-050, nuk e parashohin si vepër kundërvajtjeje “deklarin jo të plotë apo deklarim i plotë i pasurisë” e po ashtu edhe dispozitat sanksionuese në Ligjin e mëparshëm neni 16 dhe neni 17 i Ligjit i cili tani është në fuqi nuk sanksionojnë deklarin jo të plotë të pasurisë, ndërsa e pandehura është dënuar me nenin 17.1 i cili parasheh gjobë për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë.

Neni 14 i Ligjit të mëparshëm dhe neni 15 i Ligjit i cili tani është në fuqi rregullon rastet kur formularët e deklarimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë kanë mangësi gabime materiale ose plotësime të gabuara apo jo të plota në këto raste njoftohen subjektet që kanë paraqitur këto deklarime që brenda 15 ditësh pas njoftimit janë të detyruar ti përmisojnë ato.

Në plotësimin e procedurës gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike duhet të veprimi sipas vërejtjeve dhe konstatimeve të gjetura nga Kolegji dhe të ndërmerr këto veprime procedurale: të kërkoj nga Agjencioni të bëjë plotësim kërkesë duke e bazuar kërkesën e tyre në Ligjin në fuqi në kohën e kryerjes së kundërvajtjes, po ashtu të kërkoj që në plotësim kërkesë të bëhet përkrahimi faktik i veprës së të pandehurës, kohën e kryerjes së kundërvajtjes (nëse ata mendojnë deklarim i rregullt vjetor atëherë le të dihet se kur është kryer kundërvajtja a është gjerë më 31. Mars 2011, dhe të bëjë kualifikimin juridik të kundërvajtjes në nenin adekuat i cili e parasheh vepër kundërvajtjeje veprën e të pandehurës “ deklarim jo të plotë të pasurisë apo mos deklarim i pasurisë të anëtarëve të familjes”, Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave të cekura më lartë sipas nevojë të administroi edhe prova shtesë dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike të nxjerrë aktvendim të drejtë të bazuar në prova dhe Ligj. Nga të lartcekurat konform të nenit 222 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,

GJLnr.103/2012, dt. 26.01.2012.

SEK. JURIDIKE

Ganimete Dumani



KRYETARI I KOLEGJIT

Ragip Namani

Ragip Namani